



**KONTRATE SHITBLERIE**  
**KUOTASH SHOQERIE TREGTARE ( SHPK )**

Ne Fier, sot me date **31 Mars 2018 ( dymije e tetembehjete )**, para meje Noteres RITA HASA, ne studion time Noteriale te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, u paraqit personalisht Z. AGIM RESULAJ, i cili ne cilesine e tij personale dhe ne cilesine e perfaqesuesit me prokure te shtetasit EDI RESULAJ, me kerkoi redaktimin e kesaj " Kontrate Shitblerje Kuotash Shoqerie Tregtare " si me poshte vijon;

**PALA SHITSE:**

- **EDI RESULAJ**, me atesi Agron dhe amesi Verke, i datelindjes 31.01.1983, lindur ne Patos, Fier, dhe banues ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. 032521292 dhe nr. Personal I30531078S, **i cili me prokuren e pergjithshme me nr. 240 Rep, nr. 178 Kol, date 16.02.2017, perfaqesohet nga Z. AGIM RESULAJ**, me atesi - Agron dhe amesi Verke, i datelindjes 27.09.1979, lindur ne Patos, Fier dhe banues ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noteres me leternjoftimin me nr. 028334407 dhe nr. Personal H909270630

**PALA BLERSE:**

- **AGIM RESULAJ**, me atesi - Agron dhe amesi Verke, i datelindjes 27.09.1979, lindur ne Patos, Fier dhe banues ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noteres me leternjoftimin me nr. 028334407 dhe nr. Personal H909270630

**OBJEKTI I KONTRATES**

- Shitblerja e 100 % ( Njeqind Perqind ) te Kuotave te Shoqerise Tregtare " AGRO BEST ALBANIA " shpk.
- Pala Shitese, Z. EDI RESULAJ, eshte ortak i vetem i Shoqerise Tregtare " AGRO BEST ALBANIA " shpk, shoqeri e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT L73720401Q, me seli ne me Seli ne: Qarkun Fier, Kolonje, Ardenice, Rruga Nacionale Fier - Lushnje, Zona kadastrale nr. 1033, pasuria me nr. 390/67
- Nga verifikimi i dokumentacionit perkates te shoqerise se mesiperme ky subjekt tregtar rezulton me statusin " aktiv "
- Shitesi ka ne pronesi te tij 100% ( njeqind perqind ) te kuotave te shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk, per nje vlere prej:  
1 ( nje ) kuote = 100.000 ( njeqind mije ) leke.
- Me vendimin e Ortakut te Vetem te Shoqerise te dates 30 Mars 2018, eshte vendosur shitja e 100 % te kuotave te Shoqerise dhe kryerja e kontrates noteriale te shitblerjes.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 705 -745 te i K.Civil, Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ".

**GJENDJA E PASURISE OBJEKT KONTRATE:**

Pala shitese garanton palen blerese se keto kuota jane plotesisht te lira nga cdo lloj barre, pengu, detyrim ndaj te treteve ose sekuestroje mbi to, fakt i cili konfirmohet nga ana e Regjistrimit te Barreve Siguruese.

### **OFERTA DHE PRANIMI:**

- Pala shitese, Z. EDI RESULAJ, largohet nga shoqeria dhe ofron ti shese Pales Blerese pjesen e tij te kuotave qe ai zoteron ne shoqerine " AGRO BEST ALBANIA " shpk. Konkretisht ai ofron te shese 1 ( nje ) kuote qe ka ne pronesi te tij dhe qe perben 100 % ( njeqind perqind ) te kuotave te shoqerise, per cmimin total prej 100.000 ( njeqind mije ) lekesh.
- Pala blerese, Z. AGIM RESULAJ, deklaron se pranon te bleje prej pales shitese keto kuota te Shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk. Konkretisht ai blen 1 ( nje ) kuote ne pronesine e Pales Shitese dhe qe perben 100 % ( njeqind perqind ) te kuotave te shoqerise, per cmimin total prej 100.000 ( njeqind mije ) lekesh.

### **CMIMI I KONTRATES SE SHITBLERJES DHE MENYRA E LIKUJIMIT:**

- Z. AGIM RESULAJ, ne cilesine e Pales Blerese dhe ne Cilesine e perfaqesuesit me prokure te Pales Shitese, deklaron se cmimin e blerjes prej 100.000 lekesh ja ka likujduar Pales Shitese, dhe likujdimi eshte bere CASH, jashte kesaj zyre noterie.

### **KUSHTET E KONTRATES**


- Pala shitese mban pergjegjesi per te gjitha dokumentacionin perkates te pronesise mbi keto kuota te shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk.
- Pala shitese ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate heq dore mbi cdo te drejte pronesie mbi keto kuota, duke deklaruar se mbi to nuk ka te drejta pronesie dhe te drejta relative asnje pale e trete.
- Pala shitese e garanton palen blerese se keto kuota objekt kontrate jane plotesisht te lira nga cdo lloj barre pengu, detyrim ndaj te treteve, ose sekuestroje mbi to.
- Pala shitese i kalon pales blerese pronesine e plote mbi kuotat objekt kontrate, me te gjitha tagrat e pronarit te vetem te tyre.
- Ju be e ditur paleve se kjo kontrate duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit brenda afatit ligjor prej 15 ditesh, ne te kundert, ne rast vonese do te veprojne sanksionet ligjore.

**Me nenshkrimin e paleve ne kontrate Z. AGIM RESULAJ do te jete ortak i vetem i Shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk dhe do te kete ne zotirim 100 % ( njeqind perqind ) te kuotave te shoqerise, te barabarte me 1 ( nje kuote ) dhe per vleren totale 100.000 leke.**

Kjo kontrate perpilohet ne kater kopje te cilat kane te njejten vlere dhe pasi lexohet me ze te larte prej meje noteres ne pranine e shtetasit AGIM RESULAJ, ne cilesine e perfaqesuesit ne Prokure te Pales Shitese dhe ne cilesine e Pales Blerese, u gjet e shkruar drejt dhe me vullnetin e tij te plote e nenshkruan aktin ne prezencen time. Une noterja legalizoj aktin konform ligjit "Per Noterine" me Nr 7829 dt. 01 06 1994, dhe e nenshkruaj.


**PALA SHITESE  
EDI RESULAJ**

Perfaqesuar me prokure nga:

*Agim Resulaj*  


**NOTERE**

**RITA HASA**

*Rita Hasa*  


**PALA BLERESE**

*Agim Resulaj*  


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE FIER  
NOTERE RITA HASA

Nr. 240 Rep. Nr. 178 Kol



**PROKURE E PERGJITHSHME**

Sot, ne Fier, me date 16 **Shkurt 2017 ( dymije e shtatembedhete )**, para meje noteres Rita Hasa, me seli prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, u paraqit shtetasi shqiptar i meposhtem, i cili bazuar ne nenet 64-70 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise me kerkoj redaktimin e kesaj prokure te pergjithshme per sa me poshte:

**EDI RESULAJ**, me atesi Agron dhe amesi Verke, i datelindjes 31.01.1983, lindur ne Patos, Fier, dhe banues ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noteres me leternjoftimin me nr. 032521292 dhe nr. Personal I30531078S

**Shtetasi EDI RESULAJ** ne kete prokure vepron ne cilesine e perfaqesuesit ligjor dhe ortakut te vetem te shoqerise Tregtare " AGRO BEST ALBANIA " shpk, me Seli ne Ardenice, Lushnje, Rruga Nacionale Fier - Lushnje, me NIPT L73720401Q.

**POROSITES I:**

Une porositesi i mesiperm **EDI RESULAJ**, ne cilesine e perfaqesuesit ligjor dhe ortakut te vetem te Shoqerise Tregtare " AGRO BEST ALBANIA " shpk, me vullnet te lire dhe deshire te plote caktoj si perfaqesuesin tim: **Z. AGIM RESULAJ**, me atesi - Agron, i datelindjes 27.09.1979, lindur ne Patos, Fier dhe banues ne Fier, mbajtes i leternjoftimit me nr. 028334407 dhe nr. Personal JH909270630;

i cili ne emrin dhe per llogarine time si administrator dhe ortak i vetem i shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk, te kete keto te drejta:

- Te kete te drejte te paraqitet prane Ministrive te ndryshme dhe drejtorive perkatese te tyre; prane te gjitha organeve te administrates shteterore qendrore dhe asaj lokale; prane Zyrrave te Noterise dhe cdo organi tjetër privat; prane QKB-se apo QKL-se si dhe kudo tjetër ku do te jete e nevojshme per tu paraqitur ne emrin tim per te terhequr, dorezuar dhe nenshkruar cdo lloj dokumentacioni ligjor qe do te jete i nevojshem per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk, shoqeri ne te cilen une jam perfaqesuesi ligjor i saj dhe ortak i vetem.
- Te paraqitet prane Ministrise se Bujqesise, Drejtorise se Bujqesise ne rang qarku apo prane cdo institucioni qe do te kete kompetencen perkatese per te aplikuar ne emrin e shoqerise se mesiperme per marrjen e granteve te ndryshem per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise.
- Te kete te drejte qe te paraqitet prane Bankave te Nivelit te Dyte qe ushtrojne aktivitet ne Republiken e Shqiperise per te kryer dhe nenshkruar ne emrin tim te gjitha veprimet ligjore te nevojshme qe kane te bejne me marrjen e kredive bankare per ushtimin e aktivitetit te shoqerise; te aplikojte per kredi duke paraqitur te gjithe dokumentacionin e nevojshem; te kryeje dhe nenshkruaje ne emrin tim si perfaqesues ligjor dhe ortak i vetem i Shoqerise " Kontrata Kredie " me pale; vlere; afat; kushte dhe terma te kontrates se kredise si ai vete ta gjykoje te arsyeshme.
- Te paraqitet prane QKB-se per te paraqitur ne emrin tim kerkesa te ndryshme qe kane te bejne me pezullimin e perkohshem, rifillimin apo mbylljen e aktivitetit tregtar; te miratoje dhe te depozitoje bilancet e shoqerise; te miratoje dhe shperndaje dividendet e shoqerise; te depozitoje dhe terheqe prane QKB-se cdo dokument zyrtar dhe shkrese te Shoqerise duke nenshkruar ne emrin tim cdo lloj akti qe ky institucion do te kerkoje.

- Te paraqitet prane Drejtorise Rajonale te Tatim Taksave, Deges se Tatim Taksave perkatese, Deges se Sigurimeve Shoqerore, etj, per te kryer te gjitha procedurat administrative dhe financiare qe kane te bejne me shlyerjen e detyrimeve qe figurojne ne emrin e shoqerise "AGRO BEST ALBANIA" shpk.
- Perfaqesuesi im ka te drejte qe ne emrin tim te paraqitet prane Bankave te Nivelit te Dyte qe ushtrojne aktivitet ne Republiken e Shqiperise per te kryer ne emrin tim veprime dhe transakcione te ndryshme bankare si: hapje te numrave te llogarise ne emrin e shoqerise se mesiperme; derdhje lekesh dhe valute te huaj ( Euro, Dollare, etj ); shlyerje te detyrimeve te ndryshme si taksa, tatime, sigurime shoqerore dhe shendetesore dhe transfertat bankare qe lidhen me shlyerjen e ketyre detyrimeve; transfertat te ndryshme bankare qe lidhen me aktivitetin e shoqerise dhe shlyerjen e detyrimeve te saj ndaj cdo subjekti me te cilen kjo shoqeri bashkepunon; terheqje te vlerave monetare te depozituara ne numrat perkates te llogarive; mbylljen e numrave te llogarise dhe cdo veprim tjeter bankar qe perfaqesuesi im do te konsideroje si te nevojshem per ushtimin e aktivitetit te shoqerise qe une administroj. Te nenshkruaje ne emrin tim me cilesine e perfaqesuesit ligjor te Shoqerise "AGRO BEST ALBANIA " shpk te gjitha dokumentacionin e duhur per kryerjen e ketyre veprimeve bankare ne numrat perkates te llogarise te hapur ne emrin e shoqerise prane bankave te ndryshme.
- Te paraqitet prane cdo pike doganore per te kryer dhe nenshkruar ne emrin tim te gjitha procedurat administrative dhe financiare qe kane te bejne me zhdoganimin, tranzitimin, transportimin, importimin dhe eksportimin e mallrave te ndryshem qe vijne apo qe eksportohen ne emer te shoqerise qe une administroj si dhe te autorizojte per kete qellim shoqeri te ndryshme doganore te cilat do te veprojne per llogari te Shoqerise se mesiperme.
- Te kete te drejte qe te paraqitet prane DRSHTRR Perkatese per te kryer cdo lloj veprimi administrativ qe ka te beje me administrimin e mjeteve ne pronesi te shoqerise se mesiperme; te kryeje kontrollin fizik dhe teknik te mjeteve; te paguaje te gjitha taksat vjetore, siguracionet apo cdo lloj detyrimi financiar qe mund te rendoje mbi keto mjete, si gjoba, detyrime te papaguara, etj; te regjistroje kontrata te ndryshme shitblerje apo qiraje mjeteshe; te terheqe lejet e qarkullimit dhe certifikatat e pronesise se tyre; te kryeje cdo lloj veprimi tjeter administrativ prane ketij institucioni, edhe pse nuk e kam parashikuar shprehimisht ne kete prokure.
- Te paraqitet prane Zyrrave Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme per te kryer cdo lloj veprimi qe ka te beje me regjistrimin e pasurive te ndryshme te Paluajtshme qe figurojne ne emrin e shoqerise; te terheqe certifikatat e pronesise se bashku me dokumentacionin plotesues te tyre; te rifreskoje kartelat e pasurive te paluajtshme; te kryeje dhe regjistroje cdo kontrate qe ka per objekt keto pasuri te paluajtshme; te shlyeje detyrimet e ndryshme ndaj shtetit qe lidhen me keto kontrata dhe ne pergjithesi te kryejne cdo veprim tjeter qe do te kerkohet te kryhet ne emrin tim si administrator i shoqerise "AGRO BEST ALBANIA " shpk.
- Te kete te drejten e perfaqesimit tim prane Gjykatave te ndryshme kompetente te te gjitha shkalleve te gjykimit ne cdo ceshtje gjyqesore civile apo administrative ku do te jete pale ne gjykim shoqeria "AGRO BEST ALBANIA " shpk, deri ne zgjidhjen perfundimtare te ketyre ceshtjeve.
- Te kete te drejte te hartojte kerkesa apo kerkesa-padi drejtuar gjykates, ti nenshkruaje ato ne emrin tim, ti depozitoje prane Gjykatave Kompetente dhe te me perfaqesojte edhe ne mungesen time ne cdo seance gjyqesore qe do te zhvillohet ne cdo rast sipas objektit te padise se ngritur, ne cilesine e pales paditese, pales se paditur apo personit te trete te thirrur ne gjykim, per cdo lloj ceshtjeje civile apo administrative qe ka te beje me ushtimin e aktivitetit te Shoqerise "AGRO BEST ALBANIA " shpk.
- Te kete te drejten e zgjedhjes se nje avokati si perfaqesues te shoqerise ne cdo gjykim civil apo administrativ.

- Te paraqitet prane zyrave te noterise, brenda dhe jashte vendit, per te kryer dhe nenshkruar ne emrin e shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk kontrata te ndryshme qe parashikon Kodi Civil i Republikes se Shqiperise si: kontrata shitblerje apo dhurimi pasurish te paluajtshme ( kontrata ne te cilat shoqeria qe une administroj mund te jete ne cilesine e Pales Blerese, Shitese, Dhuruese apo perfituese te Dhurates ); Kontrata Bashkepunimi me shoqeri dhe subjekte te tjere ( fizike apo juridike ); Kontrata Pune; Kontrata per Perdorimin e automjeteve; Kontrata Qeraje dhe Huaperdorje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, Kontrata Furnizimi; Kontrata Shitblerje mjetesh dhe sendesh te tjera te luajtshme; Kontrata Transporti; Kontrata Kredie; Kontrata Hipoteke per efekt te marrjes se kredive nga ana e institucioneve te ndryshme financiare; Kontrata Hipoteke ne favor te personave te ndryshem fizike apo juridike; Kontrata Pengu, dhe cdo kontrate tjeter te lejuar nga ligji, duke vendosur vete perfaqesuesi im per cdo kusht te ketyre kontratave, si ta cmoje te arsyeshme.
- Te kryeje dhe nenshkruaje ne emrin tim kontrata te shitblerjes se kuotave te Shoqerise me kushtet dhe palet qe vete perfaqesuesi im do te vendose; te marre pjese ne mbledhjet e Ortakeve te Shoqerise; te jape miratimin tim per cdo kalim pronesie te kuotave; te nenshkruaje ne emrin tim procesverbalet e mbledhjeve dhe te cdo lloj vendimi qe do te marre Asambleja e Ortakeve te Shoqerise perfshire dhe vendimin per zmadhim ose zvogelim te kapitalit te shoqerise, vendimin per pezullimin apo mbylljen e aktivitetit te Shoqerise, vendimin per shitblerjen e kuotave te shoqerise dhe te cdo lloj pasurie te paluajtshme dhe te luajtshme dhe te cdo lloj vendimi tjeter te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, ne perputhje me Ligjin " Per Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi, pa asnje kufizim dhe njesoj sikur te isha vete prezent.
- Perfaqesuesi ka te drejte qe te me perfaqesoje prane cdo zyre noterie per te kerkuar kryerjen e Kontratave te ndryshme me pale, terma dhe kushte per te cilat ai do te bjere dakort, pa kufizim si me persona te trete ashtu dhe me veten e vet, veprime keto te lejuara shprehimisht nga une i perfaqesuari, sic parashikon neni 67 i Kodit Civil.
- Ne rast te mosmarreveshjeve te ndryshme, me palet e tjera kontraktore, perfaqesuesi im ka te drejte te revokoj dhe zgjidhe perpara afatit cdo kontrate te lidhur duke nenshkruar ne emrin tim cdo lloj akti noterial qe do te nevojitet per kete qellim. Gjithashtu ti drejtohet per zgjidhje edhe gjykatave te ndryshme lidhur me mosmarreveshje te ndryshme qe mund te kem ne te ardhmen me pale te tjera me te cilat do te lidhen kontratat.
- Pervec tagrave te mesiperme perfaqesuesi im ka te drejte qe te kryeje dhe nenshkruaje edhe cdo veprim tjeter ligjor, administrativ, financiar apo noterial qe do te dale i nevojshem lidhur me zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise " AGRO BEST ALBANIA " shpk, edhe pse nuk eshte parashikuar shprehimisht prej meje ne kete prokure, pa asnje kufizim dhe njesoj sikur te isha vete i pranishem, duke i deleguar atij te gjitha te drejtat qe me njeh ligji dhe duke zgjidhur cdo problem qe mund te dale me tagra dhe kompetenca te plota perfaqesimi, pa asnje kundersizim nga ana ime.

Te gjitha veprimet e kryer prej tij une i konsideroj te drejta dhe njesoj sikur ti kem kryer une vete deri sa jane ne perputhje me ligjin dhe interesat e mia dhe te shoqerise qe une administroj. Kjo prokure eshte pa afat dhe ka vlere deri sa nuk eshte revokuar prej meje me nje akt tjeter noterial.

Prokura perpilohet ne kater kopje te cilat kane te njejten vlere dhe pasi i lexohet me ze te larte porositesit, ai deklaroi se e kupton ate, bie dakord me permbajtjen e saj dhe nenshkruhet me vullnetin e tij te lire. Une noterja legalizoj aktin konform ligjit " Per Noterine " me Nr. 7829, dt. 01.06. 1994, dhe e nenshkruaj.

**POROSITESI**

Edi Rasolaj  
A

**NOTERE**

**RITA HASA**

DAPI

